



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission  
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

30/01/2025

Prishtinë

### ***DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTEVE***

Bazuar në nenin 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nxjerrë:

### **VENDIM**

***Për anulimin e procedurës rekrutuese për pozitën “ Zyrtar i Logjistikës dhe Infrastrukturës Zgjedhore” me nr. reference RAN00015551.***

- I. ANULOHET** procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Logjistikës dhe Infrastrukturës Zgjedhore”, me numër reference RN00015551, i publikuar me datën 21.10.2024.

### **ARSYETIM**

Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka publikuar konkursin për pozitën *Zyrtar i Logjistikës dhe Infrastrukturës Zgjedhore*, me numër reference RN00015551. Me rastin e publikimit të konkursit, emri i grupit për pozitën është vendosur gabimisht “Administrim i Përgjithshëm”, sipas të cilit kërkohet arsimim i paspecifikuar, ndërsa, grupi do duhej të specifikohet “Specialist Zgjedhor”, pasi që kërkohen drejtimet specifike si “Administratë Publike, Ekonomik, Juridik, Sociologji, Statistikë, Matematikë”. Ndërsa, grupi “Specialist i administrimit të përgjithshëm” kërkon “Arsimim i paspecifikuar”. Pra, grupi i profesional i përzgjedhur në konkursin e publikuar nuk përkon me kriteret e grupit që do duhej të specifikoheshin konform Rregullores Nr.08/2024, për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, SHTOJCA NR. 1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për



secilën klasë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si dhe asaj që është kërkuar.  
Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

